



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zastitu Okoline
Department for Urbanism, Planning and Environmental Protection

PLANI VJETOR I PUNËS 2025

**DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË
MJEDISIT**



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbr. i Mjedisit
Odeljenje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredine

-XII- Nr. i prot. 3148 Më 30.12.2024
Br. i prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Dhjetor, 2024

1. HYRJA

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit është e angazhuar të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm urban dhe ruajtje të mjedisit në Komunën e Rahovecit, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe nevojat e qytetarëve. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, ka hartuar planin vjetor të punës duke u bazuar në prioritetet strategjike dhe nevojat e adresuara nga qytetarët e komunës sonë. Duke u mbështetur edhe në përvojën e viteve të kaluara, plani vjetor i punës për vitin 2025 është hartuar me kujdes të veçantë, në mënyrë që të jetë i kompletuar në aspektin e zbatimit dhe përmbushjes së vizionit të qeverisë komunale. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, për vitin 2025, do të vazhdojë me të njëjtin organizim sektorial: Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

2. PËRKUSHTIM I VEÇANT I DREJTORISË PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

- Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit;
- Sheshi qëndror i qytetit;

3. OBJEKTIVAT KRYESORE TË DREJTORISË PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

- ✓ Realizimi i plotë i lëstës së projekteve kapitale për vitin 2025;
- ✓ Përfundimi dhe miratimi në Kuvendin Komunal i Hartës Zonale të Komunës;
- ✓ Vazhdimi i implimentimi ligjit për legalizimit të objekteve pa leje ndërtimore;
- ✓ Hartimi i projekteve të reja, me kompani hartuese të projekteve;
- ✓ Krijimin e hapësirave gjelbruese;
- ✓ Përgjigjia në të gjitha llojet e kërkesave ndaj personave fizik dhe juridik;

4. PLANI I AKTIVITETEVE PËR SECILIN TREMUJOR

Në tremujorin e parë të vitit 2025, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit planifikon të shqyrtojë të gjithë kërkesat nga qytetarët në afatin minimal ligjor siç janë: leje ndërtimore, leje rrënimi, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike dhe certifikatat e përdorimit. Po ashtu, synohet rritja e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, lejeve mjedisore komunale dhe legalizimin e objekteve pa leje.

Gjatë kësaj periudhe, planifikohen:

Miratimi i Hartës Zonale të Komunës;
Përgatitjet për fillimin e punimeve në projekte kapitale;
Shënimi i Ditës Botërore të Ujit.

Në tremujorin e dytë, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit planifikon të shqyrtojë të gjithë kërkesat nga qytetarët në afatin minimal ligjor siç janë: leje ndërtimore, leje rrënimi, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike dhe certifikatat e përdorimit.

Gjatë kësaj periudhe, planifikohen:

- Mbikëqyrja e projekteve kapitale për cilësinë e punimeve dhe realizimin e tyre sipas projekteve;
- Shënimi i Ditës së Tokës më 22 prill;
- Shënimi i Ditës Botërore të Mjedisit, më 5 qershor.

Në tremujorin e tretë, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit do të shqyrtojë të gjithë kërkesat nga qytetarët në afatin minimal ligjor, siç janë: leje ndërtimore, leje rrënimi, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike dhe certifikatat e përdorimit. Po ashtu, do të vazhdojë mbikëqyrja e projekteve kapitale për cilësinë e punimeve dhe realizimin e tyre sipas projekteve.

Në tremujorin e katërt, fokusi gjatë periudhës së fundit të vitit do të jetë menaxhimi sa më efektiv i projekteve kapitale të menaxhuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me organin mbikëqyrës të punimeve. Prioritet do të jetë realizimi i buxhetit dhe projekteve të planifikuara për vitin 2025 dhe shqyrtimi i bilancit të aktiviteteve të vitit.

